

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 24 SHKURT 2022

Të nderuara qytetare dhe qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Sot është një ditë e trishtuar, në fakt, për të gjithë ne që jetojmë në këtë kohë, për shkak të sulmit brutal të Rusisë ndaj një shteti sovran dhe të pavarur dhe, ashtu siç tha sot fituesi i çmimit “Nobel” Dimitri Muratov, gazetar rus: “Ukraina vuan, të gjitha vendet e tjera thuajse pikëllohen, ndërkohë që Rusia turpërohet në sy të të gjithë botës.” I gjithë populli shqiptar sot është i bashkuar në këtë qëndrim, por pa diskutim ai na bën të reflektojmë që cilido vend, i cili nuk respekton parimet e demokracisë, të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sundimit të shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës, pa diskutim që prodhon risqe të tilla. Prandaj ne, si opozitë dhe si Parti Demokratike, bëjmë luftë të përhershme për të pasur sundim të ligjit, moskapjen e institucioneve, tamam këto, të cilat duket sikur nuk marrin vëmendje publike. Në nisje, doja të thosha dy fjalë në lidhje me projektligjin e diskutuar dhe organizatën në të cilën aderohet sot Republika e Shqipërisë. Pa diskutim, siç u diskutua edhe në komision, kjo është një marrëveshje e depozituar që në vitin 2009 dhe është e vonuar; ka një kosto minimale 8000 euro në vit për Shqipërinë, por ndërkohë, nga ana tjetër, ka dhjetëra e mijëra euro të shpërdoruara nga qeveria shqiptare, për shkak të neglizhencës dhe për shkak se kjo marrëveshje është mbajtur në sirtarët e qeverisë. Siç u tha nga përfaqësuesit e qeverisë në komision, pjesëmarrja në këtë organizatë do të bëjë që trajnimet, të cilat janë bërë me kosto deri në 30 mijë euro, të kryhen me pagesa 3000 euro, por, siç është bërë e udhës nga kjo qeveri edhe në gjëra të cilat duken të vogla, edhe këtu ka shpërdorim.

Për t’u kthyer pastaj tek e gjithë propaganda dhe tek të gjitha elementet e vendosura sot si me regji, jo si ajo e “Big Brother”-it, siç tha njëri prej ministrave, se ajo është më profesionale, por nga një regji jo aq profesionale, si kjo e Partisë Socialiste, ku të gjithë ministrat apo përfaqësuesit e Partisë Socialiste thoshin të presim raportin e komisionit hetimor, por ndërkohë merreshin vetëm me komisionin hetimor. Pse merren me komisionin hetimor dhe pse merren me çështjen e plehrave, të mbetjeve apo të menaxhimit, ta quajmë si të duam? Sepse vetëm nga kjo aferë, qeveria, përfaqësuesit e saj, një grup i strukturuar me tri persona deri tani, të cilët kontrollojnë tri inceneratorët, fitojnë së paku 430 milionë euro. Tentohet të bëhet një hile, duke thënë: “Ku e dini ju që do të bëhet korrupsion në 2040-n?”. Është një kontratë e firmosur sot dhe paratë do të kalohen në çdo moment, së paku, janë 430 milionë euro, sepse, për ata që nuk e kuptojnë dhe thonë: “Po këto 45 milionë eurot e mbetjeve të inerteve apo të dherave?”, ato janë 45 milionë euro që u janë marrë ndërtuesve, por, në fakt, vendosen si kosto për çdo qytetar që blen banesë, me detyrim, te monopoli i Bashkisë së Tiranës dhe i qeverisë, për t’i çuar tek inceneratori i Tiranës dhe për të kaluar atje me një tarifë shumë herë më shumë. Për ta kuptuar: nëse një ndërtuesi do t’i kushtonte 5 euro për metër kub që nga hapja e gropës tek transporti dhe të gjitha të tjerat, 6 euro për metër kub i detyron Bashkia e Tiranës dhe qeveria të shkojnë tek inceneratori i Tiranës dhe këto janë para, të cilat nuk dalin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga xhepat e qytetarëve dhe të taksapaguesve, por në mënyrë të tërthortë. Pse kjo është një aferë korruptive dhe pse paratë që paguajnë, që tentohen të shmangen këtu sikur janë para që i paguajnë nga xhepi i tyre Edi Rama apo Erion Veliaj në Bashkinë e Tiranës, para të cilat do të paguhen nga qytetarët shqiptarë,

nga qytetarët e Tiranës, nga qytetarët e Durrësit për inceneratorin e Tiranës, po ashtu, janë para të cilat i detyron qeveria të shkojnë atje, sepse ka krijuar monopol? Si e ka krijuar monopolin dhe pse kjo është një aferë korruptive, e cila vjen erë më shumë se mbetjet? Sepse i ka shpallur fitues pa garë, pa eksperiencë, sepse janë të njëjtët njerëz në të tria kompanitë, sepse është monopol dhe sepse kanë detyruar bashkitë të paguajnë para. I mban mend kushdo lajmet me mbytyet nga plehtrat, vjet, në verë, në Durrës dhe Kavajë, gjatë gjithë kohës, ku qytetet bënin sikur mbytyeshin nga plehtrat dhe mbetjet për t'i detyruar më pas të shkonin nëpër inceneratorë. E njëjta gjë dhe në Fier. I vunë flakën dhe u bë tym e flakë i gjithë qyteti vetëm që t'i merrnin mbetjet dhe t'i çonin tek inceneratorët për të përfutur. Tani, një pyetje të thjeshtë e ka çdo qytetar që ka ndjekur edhe Kryeministrin, i cili i ka vendosur gjoksin, me të drejtë, në fakt, sepse është ai kreu i kësaj afere mafioze; nuk ka asnjë njeri tjetër në këtë vend, as fuqinë dhe as kapacitetin të vendosë në shërbim jo të gjithë qeverinë, por pothuajse të gjithë qeverinë: 6 ministri, dhjetëra agjenci shtetërore, pothuajse 6 bashki të këtij vendi, sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave; të gjithë në shërbim të një megaafere, që paratë i çon te përfaqësuesit e Partisë Socialiste! Deri më sot janë kapur disa, por pa diskutim që qytetarët shqiptarë dhe ne, si opozitë, kërkojmë që kësaj afere t'i shkohet deri në fund, ashtu siç iu shkua me komisionin hetimor.

Duhet t'i shkojë drejtësia deri në fund, për të vendosur para përgjegjësisë të gjithë personat, qofshin këta me fuqi politik ose jo. Vendosja e gjoksit nga Kryeministri, për të thënë që jam unë dhe i dal për zot vendimit, është për të intimiduar drejtësinë, për të mos shkuar deri në fund hetimi i tyre penal, sepse, pa diskutim, tek ai do të shkonte. Nëse bien një nga një këta, që kanë firmosur për llogari të tij, të gjithë do të shkonin atje. A ka një njeri që nuk i mendon në këtë vend edhe justifikimet banale të bëra dje nga Kryeministri, i cili thoshte: "Vërtet kemi harxhuar diku te 20 milionë euro te Bashkia e Elbasanit, por sot kjo bashki ka incenerator"? Po mirë, more zotëri, po për Bashkinë e Durrësit, që e keni detyruar të paguajë 15 milionë euro dhe për t'i sjellë mbetjet tek inceneratori i Tiranës, pse nuk bëtë incenerator me këto para, meqenëse kjo qenka një zgjidhje e mirë dhe t'i mbetej si pronë publike Bashkisë së Durrësit dhe t'u ulet kostoja qytetarëve të Durrësit?! Cili është qëllimi që mbetjet sillen në Tiranë? Ka vetëm një qëllim, sepse monopoli i inceneratorit të Tiranës, ashtu si dy inceneratorët e tjerë, kërkon të "hajë" dhe të gllabërojë sa më shumë para. Duke qenë se është ndërtuar si i tillë, një incenerator, i cili nuk është në funksion edhe sot e kësaj dite, por ka marrë dhjetëra e miliona euro, së paku kjo aferë do të shkojë 430 milionë euro për qytetarët shqiptarë, qofshin ata në institucione lokale, siç janë bashkitë, apo në buxhetin e shtetit. Të gjitha, në mënyrë direkte ose indirekte, dalin nga xhepat e qytetarëve shqiptarë. Nga ana tjetër, kërkojnë ta mbysin me retorikë politike, duke thënë që kjo është një situatë alarmante, për shkak të pastërtores së madhe, që qenka kjo qeveri, dhe për shkak të kushteve të vështira të mjedisit! Po dje, ky zotëri, mburrej me të madhe dhe thoshte që unë, kur isha kryetar bashkie, e kisha zgjidhur çështjen e mbetjeve me landfill-in e Tiranës.

Pra, i njëjti njeri që thotë se ishte zgjidhur, thotë që kishte probleme. E njëjta situatë, siç po ndodh me tri bashkitë, vazhdon edhe sot. Në Piskovë, meqë u fol pak më parë për dëgjesa që bëhen me qytetarët, janë ngritur qytetarët e Përmetit dhe të zonës, sepse kanë vendosur një landfill (ec e merre vesh se çfarë e quajnë në fund, se nuk ka transparencë të plotë) në hyrje të parkut kombëtar, në hyrje të rrugës, që të çon në një nga teqetë më të vizituara të zonës dhe 500 metra larg ujësjellësit të zonës. Ky është menaxhimi dhe kujdesi që ka kjo qeveri për menaxhimin e mbetjeve, ky është kujdesi i vetëm që ka qeveria, të përfutojë para dhe t'i çojë në drejtime të ndryshme. Ku? Në Maltë. Një prej personave, që është pronari real i inceneratorëve, Mirel Mërtiri, është i regjistruar me kompani offshore në Maltë. Njerëzit e tjerë, dy persona të tjerë, të cilët janë emra të vendosur nga qeveritarët, kanë bërë të njëjtin transferim dhe pastrim parash, duke i kaluar nëpër kompani të vogla, për të bërë punë të pakryera apo konsulenca, apo duke shitur në mënyrë të turpshme. Pa diskutim, më të turpëruarit në këtë situatë duhet të jenë këta dhe ky, që bën sot sikur ka bërë një zgjidhje të madhe. Kjo është një aferë

që nuk është thënë vetëm nga ne, por edhe nga institucionet e drejtësisë. Prandaj ne inkurajojmë Strukturën e Posaçme Antikorrupsion që t'i shkojë deri në fund dhe të justifikojë një më një qoftë besimin e partnerëve ndërkombëtarë, mbështetja e të cilëve nuk ka munguar as në këtë çështje, qoftë për të justifikuar taksat e qytetarëve shqiptarë, të cilët i kanë te personat më të mirëpaguar sot në Republikën e Shqipërisë, për t'i dhënë fund njëherë e mirë mosndëshkueshmërisë, korrupsionit dhe zhvatjes së parave të qytetarëve shqiptarë për t'i kaluar në 2-3 duar në vend. Faleminderit!